



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 77, datë 31.08.2015

PËR

**MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË PLANIN E PENSIONIT PROFESIONAL
PËR PUNONJËSIT E AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES
FINANCIARE**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare“, të ndryshuar, si dhe nenit 128, të Kodit të Procedurave Administrative, me propozim të Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme,

V E N D O S I:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në planin e pensionit profesional për punonjësit e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme për njoftimin, ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Enkeleda SHEHI

Në planin e pensionit profesional për punonjësit e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Neni 1, ndryshon si më poshtë:

“Në bazë dhe për zbatim të nenit 53, pika 1 të Ligjit nr. 10 197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, nenit 9, të Ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, pika 2, të Rregullores “Për marrëdhëniet financiare të punonjësve të AMF-së”, Autoriteti krijon planin profesional të pensionit për punonjësit e vet (që në vijim i referohemi si Plani Pensional)”.

2. Në nenin 11, paragrafi i dytë ndryshon si më poshtë:

“Kontributi mujor i AMF-së është në masën 5% të pagës mujore bruto të çdo punonjësi që merr pjesë në planin profesional të pensionit, por jo më shumë se kontributi që derdh AMF për sigurimin e detyrueshëm”.

3. Në nenin 12, Kontributi i punonjësit, paragrafi i dytë ndryshon si më poshtë:

“Kontributi mujor i punonjësit është në masën jo më pak se 2(dy) për qind të pagës mujore bruto të tij.

4. Në nenin 12, në paragrafin e tretë hiqen fjalët si më poshtë:

“...ndërmjet këtyre dy niveleve...”

5. Në të gjithë përmbajtjen e rregullores termi “Kryetar” zëvendësohet me “Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv”.